

FATMIRA MUSAJ

**GRUAJA NË POLITIKAT SHTETËRORE
TË MONARKISË***

A. Zogu u fut në skenën politike shqiptare me një ambicie për karrierë por edhe me një ambicie për t'a orientuar zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit drejt Perëndimit. Në vitin 1922 në postin e MP Brendshme në një letër drejtuar punonjësve të administratës e cila ka trajtën e një programi pune, ai shpalosi pikëpamjet dhe idetë e tij për ndërtimin dhe funksionimin e shtetit. Ai shprehej: “Ne duhet të riejmë (shohim - F.M.) nga perëndimi. Shqipëria ka qenë mikështa e vogël e Europës marë, ka qenë para katër shekuj e gjysëm si drita e syrit të botës së qytetnueme, pse atëherë nuk ka pasë kurrë ndonjë lidhje me orientin”.

Duke i qëndruar besnik këtij vizioni, pas kthimit në pushtet në vitin 1925, ai ideoi dhe ndërmori reforma gjatë qeverisjes. Në këto reforma do të zinte vend edhe gjendja e gruas shqiptare me problematikën e saj.

Të ngrije çështjen e gruas në këtë periudhë nuk ishte e lehtë, sepse do t'i kundërviheshe sistemit të vjetër të normave të së drejtës zakonore dhe atyre fetare me organizmat përkatëse të cilat përcaktonin pozitën e gruas dhe administronin çështjet civile të popullsisë, opinionit konservator që i mbronte ato me fanatizëm dhe të luftonjë prapambetjen ekonomike shoqërore, arsimore kulturore të vendit, e cila reflektohej më së miri në gjendjen e gruas.

Me këtë problem A. Zogu dhe administrata e tij do të ballafaqoheshin qysh në hapat e para të qeverisjes së saj. Në ankesat, letra të banorëve nga krahina të ndryshme dhe informacione të pushtetit lokal, vihej në dukje se për gruan shqetësuese mbetej pozita e saj në marrëdhëniet martesore e familjare.

Me raportet e këshillave administrative të Tropojës, Prefekturës së Kosovës (Kukës), të pleqësisë së Shpatit në Elbasan, përkatësisht gusht, tetor, nëntor 1925, trajtohet çmimi i martesës dhe fejesa e vajzës në mituri. Zakoni i çmimit të martesës ishte shuma e parave që familja e djalit i dërgonte familjes së vajzës për të bërë pajën **. Kjo shumë (nga 1500 lira) kishte arritur deri në 80

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Monarkia Shqiptare, 1928-1939”, organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

** Në Kanun, çmimi i martesës ishte përcaktuar deri 1500 lira.

napolona flori, në vitet '20-'30, praktikisht e papërballueshme për shumicën e banorëve, gjë që sillte shtyrjen e martesës për vite me radhë.

Vajza e fejuar në mituri kur rritej nuk kishte të drejtë të kundërshtonte fatin e caktuar nga prindi. Pas martese ajo shpesh do të dëgjonte refrenin “të kam ble shtrenjt”¹. Nisur nga pasojat e rënda që këto zakone sillnin në jetën e femrës e shoqërisë, këshillat e krahinave të lartpërmendura i propozuan qeverisë që çmimi i martesës të ulej deri në 15 napolona flori dhe ndalimin e fejesës së vajzave në mituri, që cilësohej si “një zakon i lig, burimi i të këqijave kur vajza rritet”². Këshilli i Ministrave mbi bazën e propozimeve të mësipërme vendosi që: “Të gjitha fejesat e kryera para moshës 17 vjeç me dhënë fjalë dhe shkëmbim nishani, para shtetit do të konsideroheshin të paqena dhe nuk kishin asnjë vlefte”³. Ky vendim ishte i detyrueshëm të zbatohet në të gjitha prefekturat.

Në kushtet kur trajtimi dhe zgjidhja e çështjeve civile edhe në vitet 1925-1928, ishte ende e drejtë e gjyqeve fetare, komisioneve të Xhibalit, qeverisja me strukturat e saj si dhe me vendimet, rregulloret që nxorri kohë pas kohe, u bë mbështetje e vajzave dhe grave në përpjekjet e tyre për të kundërshtuar zakonet e vjetra. Në të njëjtën kohë, institucionet shtetërore, po bëheshin një faktor i rëndësishëm në sheshimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme, pjesa më e madhe e tyre kishin në qendër gruan. Në dokumentacionin e kohës evidentohen raste ndonëse sporadike, ku vajzat kërkonin liri dhe të drejta në krijimin e familjes. “Nuk mund të jetoj me një burrë të vjetër, do të deklaronte një vajzë nga fshati Shesh i Tiranës, prandaj mora një djalë afërsisht të moshës sime”⁴. Ndërsa një tjetër nga Guri i Zi i Shkodrës do të pohonte: “Më është pëlqyer për fat temin djali që kam marrë, e kam vendosë me vullnet të plotë. Këtij vendimi, unë nuk do t'i shmangem kurrë”⁵. Këto dhe të tjera raste u gjykuan nga opinioni konservator si shkelje e zakoneve të vendit. Mbështetja që atyre u jepej nga strukturat e shtetit, u kritikua. Duke iu referuar një ngjarjeje të tillë, prefektura e Shkodrës, në raportimin e saj shkruante: se “shteti duhet të ndërhyjë vetëm në pajtimin e gjaqeve dhe uljen e tensioneve, e jo të përkrahë martesën e lirë të grave dhe të vajzave e ndarjen e tyre nga burri”⁶. Më poshtë vijonte: “Në qoftë se gruaja do të merret në bazë të vendimit të qeverisë ka me kenë një konflikt midis dy

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 249, viti 1925, dos VI-168, fl.4.

² Po aty.

³ Po aty, Fondi 249, viti 1925, dos. VI-168.

⁴ Po aty, Fondi 435, viti 1925, dos. 55, fl. 14.

⁵ Po aty, Fondi 646, viti 1926, dos. 30, fl. 48.

⁶ Po aty, viti 1925, dos. 28, fl.16.

bajraqeve, Shalës dhe Shoshit, ku do të bahen vrasje që mund të prishin qetësinë e këtij rrethi”⁷.

Gjithashtu në dokumente evidentohen kërkesat e grave për të mbrojtur të drejtën e trashëgimisë në atë masë sa ia njihnin ligjet e Sheriatit, kundërshtuan të drejtën që Kanuni u jepte edhe kushërinjve për të fejuar kushërirat, refuzuan martesën me vëllanë e burrit të vdekur, martesën me një burrë të moshuar ose me një djalë të mitur etj. Në pamundësi për të gjetur zgjidhje me gjyqet e Sheriatit, komisionet e Xhibalit, ato iu drejtuan qeverisë për ndihmë. Kërkesat gjithnjë në rritje për t’u dhënë zgjidhje shtetasve në çështjet civile nga njëra anë dhe vakumin ligjor shtetëror, nga ana tjetër, ishin faktorë kryesorë që A. Zogu dhe qeveria e tij t’i kushtonin vëmendje këtij problemi. Në fjalën e mbajtur para parlamentit 1928, A. Zogu do të theksonte se gjendja e vështirë e gruas ishte rezultat i veprimit të zakoneve të vjetra të vendit dhe të huaja që e kishin ulur atë në nivelin e një skllaveje. Ngritjen e nivelit dhe përmirësimin e gjendjes së saj, ai e shihte të lidhur ngushtë me zhvillimin e përgjithshëm të vendit⁸.

Një nga reformat kryesore që do t’i paraprinte konsolidimit të shtetit dhe zhvillimit të vendit ishte ajo në fushën legjislative, që u fillua me hartimin e Kodit Civil. Komisioni i ngritur në përbërje të të cilit, ishin juristë të aftë, u mbështet në përvojën e vendeve europiane si në Kodin Civil të Francës, Italisë, Zvicrës. Në të njëjtën kohë komisioni i kushtoi vëmendje edhe traditës. Në mungesë të kodeve të shkruara të së drejtës zakonore, u organizuan takime me popullsinë e Malësisë së Madhe, të Dukagjinit etj. Mbështetur në të dhënat e nxjerra nga bisedimet dhe diskutimet e zhvilluara, komisioni arriti në përfundimin se norma të kanunit të Lekë Dukagjinit që aplikoheshin aty nuk mund të ruheshin dhe të ktheheshin në ligje, sepse, sipas tyre, ato kishin humbur origjinalitetin dhe nuk mund të përshtateshin me zhvillimin aktual ekonomik e shoqëror të vendit. Edhe organizmat që merreshin me zgjidhjen e çështjeve shoqërore të mbështetura në normat e mësipërme e kishin humbur funksionin e tyre. Kështu, banorët e këtyre krahinave shpreheshin se komisioni i Xhibalit ishte kthyer në një organizëm ku mbizotëronin abuzimet, padrejtësitë dhe hatëret⁹. Prandaj ata kërkonin që këtij komisioni t’i hiqej njëherë e përgjithmonë e drejta për të zgjidhur problemet e tyre dhe se këtej e tutje të zbatoheshin ligjet e shtetit¹⁰. Në relacionin që iu paraqit komisionit për hartimin e Kodit Civil theksohej: “Në këto vise, as populli as autoritetet lokale nuk e duan zbatimin e kanunit të Lekë Dukagjinit. Kur i pyetën krerët e Dushmanit se a e dëshironin zbatimin e e tij nëpërmjet Kanunit të Xhibalit, ata u përgjigjën:

⁷ *Po aty*, viti 1926, dos. 30, fl. 48.

⁸ *Fletorja Zyrtare*, 13 maj 1928, nr. 50, f. 4.

⁹ *AQSh*, Fondi 648, viti 1927, dos. 169, fl.1.

¹⁰ *Po aty*.

“jo, na duem të gjykohemi me njet kanu që do të gjykohet e tanë Shqypnia”¹¹. Mbi këtë bazë komisioni krijoi bindjen se Kodi Civil dhe ligjet e reja do t’i jepnin fund praktikës së deriatëhershme të gjykimit mbi normat fetare dhe të së drejtës zakonore.

Në fund të vitit 1927, projekt Kodi Civil iu paraqit për diskutim dhomës së deputetëve dhe senatit dhe hyri në fuqi në prill të vitit 1928. Kodi Civil do të sillte ndryshime esenciale në pozitën e gruas në familje, si në fejesë, martesë, trashëgimi etj.

Duke vlerësuar rolin e barabartë që luante gruaja në krijimin dhe zhvillimin e familjes, ishte parashikuar të zhdukej pabarazia e saj në familje e cila shpallej monogame. Aty u vendosën ligje të njëjta për të gjithë shqiptarët, për lidhjen dhe zgjidhjen e martesës, për raportet midis burrit dhe gruas në marrëdhëniet pas martesës etj.

Gruas i njihej e drejta e barabartë me burrin në institucionin e trashëgimisë, në familjen e atit dhe në atë bashkëshortore, u barazua trashëgimia midis gjinisë prej ati me atë prej amë. Iu hoq e drejta e gjinisë, për të marrë pjesën më të madhe në trashëgiminë në një familje që kishte vetëm vajza¹².

U sanksionua e drejta e gruas për të ndarë burrin¹³, vajzës iu njoh e drejta për të prishur fejesën dhe u barazua me djalin në pasoja juridike që vinin nga ky veprim. Megjithatë ligji për fejesën pati edhe kufizime. Ai e lejonte lidhjen e saj sipas zakoneve të vendit¹⁴. Kufizime të tjera u vrejtën në kapitullin mbi të drejtat dhe detyrat e bashkëshortit në të drejtën e saj për punësim, mohimin e së drejtës së votës, çka dëshmon se edhe legjislatorët nuk ishin të shkëputur krejtësisht nga mentaliteti konservator për gruan.

Kodi Civil shënonte një hap të rëndësishëm në përmirësimin e pozitës së gruas në familje por do të sillte ndryshime edhe në shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Ai u vlerësua dhe konsiderua nga shtypi i kohës si një dritare e gjerë që sheh nga perëndimi, si një mjet që do të lironte gratë nga skllavëria, do të forconte damarët qytetërues të brezit tonë, do të armatosë me të gjitha mjetet e rezistencës dhe të aktivitetit për të realizuar qëllimet e neoshqiptarizmes¹⁵.

Pati edhe shkrime në të cilat ligjet e Kodit Civil për njohjen e të drejtave të grave, u panë me rezervë madje dhe u kritikuan. Në një artikull të “Gazeta e re” shkohej deri aty sa autori e quajti si një hap të gabuar të seksit mashkullor ndihmën që po i jepte seksit femëror e që do të vinte koha që ata do të

¹¹ *Po aty*, Fondi 248, viti 1927, dos. VI-6, fl. 5.

¹² *Kodi Civil*, Vlorë, prill 1928, neni 457.

¹³ *Po aty*, neni 208.

¹⁴ *Po aty*, neni 114, f. 57.

¹⁵ *Gazeta Demokratia*, 3 prill 1929, nr. 202, f.1; *po aty*, 25 maj 1929, nr.208, f.2.

pendoheshin¹⁶. Edhe revista “Lajmtari i zemrës i Jezu Krishtit” në një varg shkrimesh u shpreh kundër kapitullit të divorcit dhe mbronte sakramentin e martesës. Aty u pasqyruan norma të fesë katolike që përjetësonin pushtetin e burrit ndaj gruas në familje, gruaja sipas tyre, ishte një krijesë që duhej t’i nënshtrohej burrit si Zotit, sepse burri asht mbi gruen si Krishti mbi kishën¹⁷.

Gjatë zbatimit në praktikë ligjet e Kodit Civil do të hasnin në vështirësi të cilat ishin të karakterit objektiv dhe subjektiv. Niveli i ulët ekonomik, shoqëror dhe kulturor i vendit, normat e së drejtës zakonore dhe ato fetare me organizmat e tyre që kishin qeverisur në shekuj, nuk mund t’i hapnin rrugë lehtë të resë. Mentaliteti konservator për gruan që dominonte në shoqëri edhe në një pjesë të madhe por që pranohej edhe prej saj. Veç pengesave pati edhe faktorë favorizues që mbështetën zbatimin e tij, si shteti me strukturat e tij, forcat përparimtare dhe gratë intelektuale.

Një nga nenet e Kodit Civil që hasi pengesa në zbatim ishte neni 151, ku sanksionohej akti i kurorëzimit. Sipas këtij neni, kurorëzimi duhej të kryhej në zyrat civile, para nëpunësit, në prani të dëshmitarëve me miratimin e djalit e të vajzës. Banorë të fshatrave të Dibrës dhe Elbasanit ndonëse ishin dakord me ligjin, i kërkonin Ministrisë së Punëve të Brendshme që punonjësi i gjendjes civile të shkonte në shtëpitë e tyre për të kryer formalitetet.

MPB iu përgjigj pozitivisht dhe nënvizoi që kjo praktikë të zbatohet përkohësisht¹⁸. Kjo praktikë duket se u erdhi për shtat prindërve, sepse nuk mundësonte ballafaqimin fizik midis të fejuarve dhe evitonte çdo problem që mund të dilte prej tij. Kjo praktikë u përhap me shpejtësi edhe në zona të tjera të vendit. Një veprim i tillë në shtypin e kohës u konsiderua si rezistencë që i bëhej ligjit dhe u kërkua që shtetasit t’i binden atij, të paraqiten në zyrat civile për të kryer formalitetet e celebrimit¹⁹.

E drejta për shkrorëzim u shfrytëzua nga gratë për të denoncuar shkeljet dhe abuzimet që prindi bënte me liritë dhe të drejtat e saj gjatë fejesës, ndaj padrejtësive dhe keqtrajtimit në familjen bashkëshortore, kundër ndërhyrjeve të familjes dhe të afërmeve për ta detyruar për të qëndruar edhe në atë gjendje në familjen e burrit. Ato kërkonin që denoncimet e tyre të gjykoreshin mbi bazën e ligjeve të reja të Kodit Civil, e jo sipas normave të Kanunit.

E drejta e gruas për shkrorëzim u kundërshtua nga kleri katolik jo vetëm gjatë diskutimit të Kodit Civil në parlament por edhe gjatë zbatimit të tij. Ajo mobilizoi klerikët e të gjitha niveleve për të bindur popullsinë katolike t’i qëndronte besnike kunorës së vënë në kishë. Angazhimi i kishës në këtë drejtim

¹⁶ *Gazeta e Re*, 28 prill 1929, nr. 148, f.2.

¹⁷ Revista *Lajmëtari i zemrës s’Jezu Krishtit*, shkurt 1930, n.2, f. 23-24.

¹⁸ *AQSh*, Fondi 646, viti 1929, dos. 39, fl.1.

¹⁹ *Gazeta Drita*, 15 mars 1937, nr. 88, fl.2.

pengoi, por nuk mundi të ndalonte gratë dhe vajzat e këtij besimi, të ushtronin të drejtat e tyre për shkurorezim që u jepte ligji.

Megjithatë, kisha katolike ashtu si dhe dy komunitetet e tjera fetare në përgjithësi i pranuan ligjet. Madje kisha katolike luajti rol pozitiv në luftën kundër zakoneve të vendit që zbatoheshin edhe nga popullsia katolike e veriut, si fejesa e vajzave në mituri, martesë pa pëlqimin e tyre, çmimit të martesës etj.

Në vitet 30, shqetësim mbeti fejesa e vajzave në mituri dhe çmimi i martesës. Në dokumentet e kohës pohohej se ato vepronin me të njëjtin intensitet si më parë. Veprimi i tyre shihej edhe si pasojë e mangësive që përmbante ligji për institucionin e fejesës, në të cilin nuk ishte parashikuar ndonjë nen që të ndalonte fejesën e vajzës në mituri. Prandaj banorë të zonave të ndryshme kërkonin pranë institucioneve shtetërore që ky fenomen të ndalohej me ligj²⁰.

Në përgjigje të kërkesave të tyre MPB në vitin 1933 paraqiti për miratim projektligjin për rregullimin e fejesave. Miratimi i këtij ligji ishte i domosdoshëm, theksohej ndër të tjera në raportin e MPB dhe për arsye se çmimi i martesës ishte kthyer në një zakon të neveritshëm që sillte robërimin e plotë të vajzës²¹. Siç theksohej në relacionin sqarues të MPB “E fejuar në këto rrethana vajzës i imponohej martesë me një njeri me të cilin nuk përkonte as me moshë e as me karakter²²”.

Ligji u miratua në parlament dhe u dekretua nga mbreti në prill 1934.

Në ligj përcaktohej si optimale për fejesën e vajzës mosha 14 vjeç, para kësaj moshe fejesa ndalohej dhe konsiderohej e paqenë. I hiqej e drejta prindit ose kujdestarisë për ta fejuar atë nën këtë moshë në emër të saj. Ndalonte fejesën pa dëshirën e saj.

Parashikohej ndëshkimi për të gjithë prindërit ose çdo person tjetër që pengonte ekzekutimin e martesës. Aty përcaktohej procedura që duhej ndjekur në rastet kur njeri nga të fejuarit kërkonte të prishte fejesën, kjo mund të kryhej pa pasur asnjë pasojë. Po atë vit këshilli i ministrave nxori vendimin ku caktonte si çmim për pajën e vajzës shumën prej 15 napolona flori²³. Për zbatimin e ligjit MPB udhëzonte organet e pushtetit lokal të bashkëpunonin me pleqësitë e fshatrave dhe bajraktarët e krahinave në mënyrë që të propagandohej dhe sqarohej popullata për kërkesat e ligjit²⁴.

Gjatë këtyre viteve u miratuan ligje dhe dolën vendime, udhëzime që synonin përmirësimin e gjendjes së gruas. Kështu, në vitin 1929 doli vendimi i

²⁰ *AQSh*, Fondi 471, viti 1932, dos. 97, fl. 1.

²¹ *Po aty*, Fondi 249, viti 1933, dos. VI-406, fl. 15.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*, Fondi 252, viti 1934, dos. 286, fl. 11.

²⁴ *Po aty*, viti 1935, dos. 692, fl. 20.

qeverisë që ndalonte të ngarkuarit e grave²⁵. Në vitin 1931 u miratua ligji mbi ndalimin e martesës ilegale²⁶. Sipas tij dënoheshin jo vetëm burri dhe gruaja që bashkoheshin në bazë të zakoneve të vendit, të pancelebruar, por edhe prindërit, pleqësitë e katundeve si dhe fetarët që kishin dijeni për një bashkim të tillë. Në vitin 1932 hyri në fuqi kodi tregtar në nenet e të cilit mbroheshin të drejtat e gruas së të falimentuarit²⁷.

Në vitin 1935 qeveria shqiptare nënshkroi Konventën Ndërkombëtare të Punës për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve në procesin e punës. Një vit më vonë qeveria e M. Frashërit, nxorri vendimin që u njihte vajzave dhe grave të drejtën për të konkuruar krah burrave për t'u punësuar në administratën shtetërore.

Në vitin 1928 qeveria nxorri vendimin ku ndalonte emigrimin e grave jashtë vendit. Ndonëse ky vendim kishte karakter ekonomik (synonte të tërhiqte valutën brenda vendit) ai shkelte të drejtën e grave për emigrim. U hiqte mundësinë për bashkim familjar. Gratë reagues ndaj këtij vendimi. Në letrat dhe ankesat drejtuar institucioneve përkatëse, kërkuan rishikimin e këtij vendimi²⁸.

Në vitin 1937 u dekretua ligji për heqjen e perçes. Ngritja e problemit të perçes dhe dëmeve që sillte ajo në jetën e femrës dhe të shoqërisë kishte filluar qysh në fillim të viteve 20 por u intensifikua sidomos gjatë viteve 1925-1939 në qeverisjen e A.Zogut. Madje në këtë periudhë pati një zhvillim të gjerë ku morën pjesë Kryesia e Komitetit Mysliman, inteligjencia e kohës, shtypi dhe organet përkatëse qeverisëse të vendit. Në vitin 1929 kryetari i Komunitetit Mysliman Bexhet Shapati në letrën drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, argumentonte heqjen e perçes dhe përmirësimin e veshjes së gruas myslimane. Ai theksonte se zakoni i mbajtjes së perçes nuk ishte normë e fesë islame. "Asht e vërtetë, - theksonte ai, - që femra myslimane duhet të mbulojë gjymtyrët, e caktueme deri në vendin që e jep edukata qytetare por jo fytyrën"²⁹. Ai kritikonte mënyrën e veshjes së gruas në Tiranë e cila cilësohej si një veshje jashtë çdo edukate qytetare, fetare dhe njerëzore, zbulimi i fytyrës do të sillte përmirësimin e veshjes së tyre. Propozimi i tij u mbështet nga intelektualët në qytetet më të mëdha të vendit. Një grup intelektualësh të Elbasanit kërkuan që të hiqej bashkë me perçen edhe ferexheja. "Ne presim nga kryefetarët sa edhe prej masave qeveritare zhdukjen e ferexheve me gjith napë dhe zëvendësimin e saj me veshje të kohëve të sotme"³⁰.

²⁵ *Po aty*, viti 1929, dos. 124, fl.2.

²⁶ *Po aty*, Fondi 246, viti 1931, dos. 35.

²⁷ *Fletorja zyrtare*, 5 mars 1932, n.10, f. 113.

²⁸ *Gazeta Dielli*, 29 janar 1929, n. 5043, f. 4.

²⁹ *Gazeta e re*, 18 gusht 1929, nr. 240, f. 2.

³⁰ *Po aty*, 3 shtator 1929, n. 253, f.3.

Në faqet e shtypit iu kushtua vëmendje këtij problemi. Heqja e perçes si edhe eliminimi i zakoneve të tjera do të ndihmonte në çlirimin e gruas dhe do ta bënte atë një faktor në shoqërinë shqiptare³¹.

Gjithashtu përfaqësues të fesë veç organeve të shtypit shfrytëzuan takime me qytetarët për të propaganduar idenë e heqjes së perçes dhe përmirësimin e veshjes së gruas.

Në mars të vitit 1937, Këshilli i përgjithshëm i Komitetit Mysliman me propozim të Kryesisë ndaloi mbajtjen e perçes. Këtë vendim ia paraqiti Këshilli të Ministrave ku midis të tjerash theksohej: “Në shek. XX dhe në mes të Evropës, kur shohim se nuk kemi as më të voglin ndalim fetar, duhet të adaptojmë të gjitha zakonet e mira të kombeve të qytetnueme”³². Mbi bazën e këtij vendimi Këshilli Ministror në mars 1937 paraqiti projektligjin për heqjen e perçes, i cili u dekretua nga Mbreti³³. Ai e vlerësonte ligjin si një hap të rëndësishëm për lartësimin e gruas shqiptare, jo vetëm në dobi të zhvillimit të individualitetit të saj por edhe të familjes, atdheut e shoqërisë³⁴. Në ligj ndalohej mbulimi i fytyrës pjesërisht ose tërësisht me çdo mjet. Kundravajtësit dënoheshin me gjobë deri në heqje lirie. Ligji nuk binte ndesh me normat e fesë islame për veshjen e gruas sepse ai nuk prekte elementë të tjerë të veshjes.

Masat e marra nga qeveria për zbatimin e ligjit si dhe mbështetja që iu dha nga krerët e Komitetit Mysliman bëri që në qytetet më të mëdha të vendit, gratë të lëviznin pa perçe. Pati dhe raste si në Shkodër dhe Kavajë ku ligji hasi vështirësi në zbatim.

Ligjit për heqjen e perçes iu bë jehonë edhe në shtypin e huaj. Ai u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt përparimit, si përpjekje për t’u larguar nga orientizmi e për t’u futur në rrugën e qytetërimit evropian³⁵.

Kuptimi dhe zbatimi i ligjeve të reja ashtu si dhe i gjithë zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit kërkonte domosdoshmërisht arsimimin e popullsisë dhe sidomos të femrës, niveli arsimor i së cilës ishte mjaft i ulët.

Nismat që ishin marrë në fushën e arsimit kombëtar gjatë periudhës së republikës u panë të pamjaftueshme nga mbreti dhe qeveria për zgjidhjen e problemeve që kërkonte zhvillimi i arsimit kombëtar. Këtë ai mendoi ta arrinte nëpërmjet zbatimit të reformës arsimore. Për përgatitjen e hartimin e programeve të saj, në vitin 1929 u ngrit komisioni i kryesuar nga ish ministri i arsimit, A.Dibra. Në kuadër të politikave për zhvillimin e arsimit kombëtar komisioni i kushtoi vëmendje të veçantë arsimimit të femrës. Veçanërisht u tërhoq vëmendja për gjendjen e rëndë arsimore të vajzave në zonat rurale. Për

³¹ *AQSh*, Fondi 58, viti 1937, dos. 209, fl.1.

³² *Gazeta Drita*, 3 mars 1937, n. 77.

³³ *AQSh*, Fondi 58, viti 1937, dos. 209, fl.1.

³⁴ *Po aty*, dos. 69, fl.5.

³⁵ *Po aty*, Fondi 251, viti 1937, dos. 75, fl.85.

këtë arsye u vendos riorganizimi i sistemit arsimor të shkollave fillore e të mesme femërore dhe të çelëshin shkolla të reja në zonat rurale duke u pajisur me konvikt, për t'u ardhur në ndihmë vajzave në zonat malore që nuk kishin mundësi t'i ndiqnin ato. Reforma synonte të përmirësonte përmbajtjen e programeve mësimore dhe unifikimin e tyre.

Në zbatim të reformës në prill 1933 parlamenti vendosi të ndryshonte nenet 206-207 të statutit mbretëror. Në nenin 206 të ndryshuar mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë konfirmohej si e drejtë ekskluzive e shtetit. Nxënësit do të shkolloheshin vetëm në institutet shtetërore. Aty shpallej se arsimit fillor ishte i detyrueshëm dhe falas për të gjithë shtetasit shqiptarë. Parlamenti vendosi që shkollat private të çdo kategorie të mbylleshin³⁶. Megjithatë për nevojat arsimore të popullatës në ligj u la një klauzolë sipas të cilës shkollat private, mund të funksiononin nëqoftëse bashkëpunonin me shtetin për të çelur shkolla në ato vende ku ai nuk kishte mundësi t'i hapte vetë³⁷.

Në zbatim të reformës për shtetëzimin e shkollave në vitin 1933, u mbyllën Instituti "Qiriazi" në Kamëz, shkolla normale "Stigmatine" e klerit katolik në Shkodër, Instituti privat femëror "N. Frashëri". Për të unifikuar arsimin e mesëm femëror atë normal dhe gjimnazial, ministria e Arsimit mbylli të vetmen shkollë normale femërore shtetërore në Korçë. Në këtë qytet me nxënëset e klasave të ulëta të ish normales u çel një shkollë qytetëse katërvjeçare, ndërsa në Shkodër me kontigjentin e vajzave të shkollës "Stigmatine" do të çelëj dega e ulët femërore pranë gjimnazit të Shkodrës³⁸.

Në vend të këtyre institucioneve u ngrit në Tiranë instituti femëror "Nana Mbretëshë" me dy degë të plota normale dhe gjimnaziale me program tetëvjeçar³⁹. Me vendim të Këshillit të Ministrave në këtë institut do të vazhdonin studimet nxënëset e katër shkollave të suprimuara⁴⁰. Numri i nxënësve në këtë institut erdhi gjithnjë në rritje, nga 388 në vitin shkollor 1933-34 në 510 në vitin shkollor 1936-1937. Përqendrimi i arsimit të mesëm normal femëror në këtë institut pati rëndësi për përmirësimin e përmbajtjes së programit dhe të ngritjes cilësore të mësimdhënies sepse në këtë shkollë u përqendruan forcat më të kualifikuara brenda vendit si dhe me kuadro nga vende të tjera.

Megjithatë duke qenë i vetmi institut femëror në Shqipëri çoi në kufizimin e numrit të vajzave që dëshironin të vazhdonin studimet për mësuesi. Kjo për arsye se mundësitë financiare ishin të kufizuara, gjë që evidentohet në

³⁶ *Po aty*, Fondi 495, viti 1933, dos. 1, fl. 1.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *Po aty*, viti 1934, dos.4, fl.3.

⁴⁰ *Po aty*, viti 1933, dos. 50, fl. 104-105.

kërkesat e tyre në rritje drejtuar institucioneve shtetërore për bursë, dhe nga ana tjetër mundësitë e pakta që kishte shteti për t'i u ofruar atyre këtë mbështetje. Nisur nga kërkesat në rritje të vajzave nga krahina të ndryshme, si dhe nga nevoja për mësuese, ministria e Arsimit, riçeli shkollën Normale shtetërore të Korçës filloi pranimiti i vajzave për t'u shkolluar në Liceun e Korçës, në Normalen e Elbasanit si dhe të ndiqnin mësimet në gjimnazin e Gjirokastrës e atë të Shkodrës.

Për të përmirësuar gjendjen arsimore të vajzave në zonat fshatare në ligjin për reformën arsimore ishte parashikuar çelja e kurseve dhe e shkollave 2 vjeçare me karakter bujqësor⁴¹. Përveç kthimit të normales femërore në shkollën bujqësore të Kavajës në këtë tip shkolle, në pjesët e tjera të vendit kjo nuk u realizua, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, kuadrove arsimore etj.

Për përmirësimin e gjendjes arsimore në malësitë e veriut në vitin 1932 u çel konvikti për vajza në Homesh ku u sistemuan vajza nga krahinat malore të Kukësit, Dibrës, Elbasanit, të cilat pasi të mbaronin shkollën të ktheheshin në vendet e tyre e të kontribuonin në arsimimin e vajzave. Gjithashtu u dhanë orientime që të punohej me prindërit që të dërgonin vajzat për t'u arsimuar edhe në shkollat e përziera. Në disa qytete të Shqipërisë si Shkodër, Tiranë, Korçë etj. u çelën shkolla femërore fillore të reja. U rrit numri i nxënësve që i frekuentonin shkollat e përziera etj. Mbështetur në të dhënat dokumentare në vitet 30 arsimit femëror ashtu si i gjithë arsimit kombëtar pësoi rritje si në shtrirje e përmbajtje dhe frekuentim. Në vitin 1934-1935 në 575 shkolla fillore të vendit mësonin 50890 nxënës prej të cilëve 14.944 ishin vajza⁴² kundrejt 5082 që vijonin shkollën në vitin 1926-1927. Ritme të mira u vunë re edhe në arsimin e mesëm. Në vitin 1934-1935 në shkollat normale të vendit nga 308 nxënës gjithsej 106 ishin vajza, ndërsa numri i nxënësve që ndiqnin gjimnazet ishte 2303, prej të cilëve 529 ishin vajza kundrejt 117 vajzave që i ndiqnin ato në vitin 1926-1927 dhe dy vjet më vonë ky numër u dyfishua⁴³.

Në kuadër të reformës arsimore vëmendje iu kushtua arsimit profesional të vajzave sidomos në shërbimin shëndetësor për infermiere, mami disa prej tyre u dërguan me bursë shteti për studime në Itali, Francë, Jugosllavi⁴⁴. Gjithashtu vajzat ndoqën shkolla profesionale teknike, bujqësore dhe tregtare numri i të cilave në vitin 1933-1934 ishte 250⁴⁵. Arsimiti i vajzave brenda dhe

⁴¹ *Po aty*, Fondi 58, viti 1934, dos. 639 (Për organizimin dhe përmbajtjen e programit mësimor të shkollave dyvjeçare të parashikuara në ligjin për reformën arsimore, shih Fatmira Musaj: Gruaja në Shqipëri, 1912-1939, Tiranë 2002, f. 236).

⁴² *Kuvendi Kombëtar*, 22 prill 1935, n. 45, f.1.

⁴³ *Shkolla Kombëtare*, 28 nëntor 1937, nr.5, f.7.

⁴⁴ *AQSh*, Fondi 245, viti 1934, dos.IV-370, fl. 146.

⁴⁵ *Kuvendi Kombëtar*, 22 prill 1935, nr.45, f.1.

jashtë vendit iu dha atyre mundësi të punësoheshin kryesisht në arsim dhe shëndetësi. Në vitin 1937, numri i arsimtarëve në vend kishte arritur në 345⁴⁶.

Megjithë arritjet e shënuara në arsimin kombëtar, në këtë kuadër edhe të shkollës femërore referuar statistikave shkollore të drejtorive arsimore në këtë periudhë, arrihet në përfundimin se me disa përjashtime të vogla vajza në fshat dhe sidomos në zonat malore ishte e paarsimuar. Një gjendje e tillë shpjegohej me mungesën e theksuar të mjeteve financiare për të përballuar një shtrirje të rrjetit të shkollave femërore dhe të përziera edhe në këto pjesë të vendit, me mungesën e kuadrit mësimor dhe prapambetja më e madhe e këtyre zonave krahasuar me ato urbane.

Si përfundim mund të themi se reformat e ndërmarra në vitet 1925-1939, patën rëndësi edhe për gruan. Ato shënuan hapa në përmirësimin e pozitës juridike të gruas në familje në shkollimin, në punësimin e saj në arsim, shëndetësi, në industrinë e lehtë dhe ushqimore etj. Ato i çelën udhë një procesi të gjatë, të vështirë, kompleks të çlirimit, emancipimit dhe barazisë gjinore, proces që vazhdon edhe sot në Shqipëri e vende të tjera të botës.

⁴⁶ *AQSh*, Fondi 646, viti 1937, dos. 823, fl. 89.

